

NN, FDH-35413; deklarata Xh.S, FDH-35414; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 75, FDH-23816; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 21-32, 909-910; KMKKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; Z. Stijović, *Kosmet...*, 116; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.D.298.6.5, FDH-30909; AIS, *Zona...*, 56, FDH-16913; FHP, *Haški tribunal, Sudenje Slobodanu Miloševiću*, XVIII, 251-252; *Salija, izadi ili čemo ti ubiti sina*, Ilustrovana politika, 18.04.1998, FDH-32147; *Čovek ubijen, selo čuti*, Ilustrovana politika, 24.01.1998, FDH-32136; *Teroristi mučili i ubili 67 nedužnih civila*, Politika, 14.9.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>.

## Raba (Sylë) Gashi

(1964, shqiptare nga Vojniku/Voćnjak, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, tre fëmijë)

## Asllan (Sylë) Gashi

(13.06.1971, shqiptar nga Vojniku/Voćnjak, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtime, një fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

## Meride (Hajzer Demiri) Gashi

(6.10.1972, shqiptare nga Vojniku/Voćnjak, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise, një fëmijë)

Vëllezërit Asllani, Zeqiri, Xhaviti dhe Neziri me familjet e veta dhe prindërit jetonin në Vojnikë/Voćnjak. Në muajin maj të vitit 1998, forcat serbe u stacionuan përmbi fshatin Burojë/Broćna, nga ku qartazi shiheshin shtëpitë në Vojnikë/Voćnjak. Dita e **një majit të vitit 1998** ka kaluar qetë. Në mbrëmje, për një vizitë të vëllezërit dhe prindërit ka ardhur motra Raba me fëmijë. Rreth orës 23:00, Asllani po përgatitej të nisej në detyrë ushtarake, ndërkaq familjarët e tjerë për gjym. Përnjëherë, i vërejtën dy makina me drita të ndezura që kaluan pranë shtëpisë [**Vojnikë/Voćnjak**]. Menjëherë pas tyre, në oborr u dëgjua një shpërthim i fuqishëm. Të kapluan nga paniku, të gjithë dolën në ballkon. Në ato çaste u dëgjua edhe eksplozimi i dytë në oborr. Asllani dhe motra e tij Rabe u qëlluan për vdekje në vend, ndërkaq bashkëshortja e Asllanit, Meridja, u plagos rëndë në kokë dhe në gjoks. Vajza e vogël Erblina, të cilën Meridja e mbante ngrykë, nuk e lëndua. Me këtë rast, u plagosën edhe prindërit Sylja dhe Zahidja. Xhaviti i

ka çuar menjëherë të plagosurit te mjeku në Izbicë/Izbica, por Meridja ndërroi jetë në rrugë e sipër. Një ditë më vonë, familjarët i kanë varrosur Asllanin, Meriden dhe Raben në varrezat e fshatit.

**Burimet:** deklarata X.G, FDH-17345; deklarata A.M, FDH-34196; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 114, FDH-23816; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 58, FDH-23857; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

## Idriz (Rexhep) Idrizi

(1953, shqiptar nga Prekazi i Poshtëm/Donje Prekaze, komuna e Skënderajt/Srbica, korrier, dy fëmijë)

Shtëpia në të cilin Idrizi jetonte me bashkëshorten dhe fëmijët gjendej përballë Fabrikës së Municionit në **Prekazin e Poshtëm/Donje Prekaze**. Idrizi punonte si korrier në shkollën fillore në fshat. Në datën **9.05.1998**, rreth orës 10:00, Idrizi doli nga shtëpia dhe u nis për në Skënderaj/Srbica ku duhej ta merrte pagën mujore. Nga ajo ditë, atij i zhdukët çdo gjurmë. Emri i tij edhe sot gjendet në evidencën e KNKK-së për persona të zhdukur. Rasti i tij është sistemuar në lëndën me numër BLG-802591-01.

**Burimet:** deklarata S.I, FDH-20308; KMDLNJ, *Buletini*, num. 6, janar-mars 1998, 160, FDH-23807; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

## Rifat (Hasan) Çitaku

(5.05.1940, shqiptar nga Çitaku/Çitak, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor, shtatë fëmijë)

## Muhamet (Shaban) Çitaku

(8.02.1969, shqiptar nga Çitaku/Çitak, komuna e Skënderajt/Srbica, i papunë, pjesëtar i UÇK-së)

Rifati punonte në kooperativën bujqësore. Me familje jetonin në *Mëhallën Çitaku* [fshati **Çitak/Çitak**]. Përballë shtëpisë së tij jetonin i vëllai Shabani me djemtë Muhametin dhe Naimin me familjet e tyre. Muhameti ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Ishte i martuar me Zylfijen. Në mëngjesin e datës **15.05.1998**, forcat serbe erdhën nga drejtimi i Istogut/Istok dhe i morën pozicionet përmbi *Mëhallën Çitaku*. Pas pak, nisën të shtënin mbi shtëpitë e mëhallës. Rifati dhe Muhameti me familjet